


NGJYRAT E MENDIMEVE



DEMOKRATIKE

DEMOKRACIA NË VENDIN TONË

ERBLIN (14), ENES (14), PRANVERA (14), ALBINA (14), FATLUM (14), ANJEZA (14), ERBLINA (14),

RIAD (15)



Fjala jonë dëgjohet...

Në jetën e përditshme, kur përmendet fjala demokraci, gjëja e parë që na vije në mendje është liria dhe barazia e popullit. Suksesi i një shteti varet vetëm nëse bashkëpunojnë të gjithë qytetarët dhe nëse kanë liri të vendosin për jetën e tyre dhe për shtetin e tyre.

Gjatë rrugës së jetës, ne ballafaqohemi me sfida të ndryshme, të cilat ndonjëherë na bëjnë të ndihemi të shtypur. Ndonjëherë na bëjnë të ndihemi edhe sikur dikush ka të drejta më shumë se ne, e nuk mendojmë anëtarë pozitivë që demokracia na i sjell.

Demokracia si koncept i rëndësishëm për çdo shtet, na bën të kuptojmë se çdo qytetar ka të drejtat e veta dhe se ajo i bën të gjithë qytetarët të ndihen të lirë. Madje, demokracia është zhvilluar aq shumë, sa që vetë qytetarët votojnë për përfaqësuesit e tyre. Kur jemi këtu, ne dallojmë demokracinë e drejtpërdrejtë dhe atë përfaqësuese. Ndërsa, tek demokracia përfaqësuese kemi sistemin parlamentar dhe sistemin presidencial. Çdo njeri ka të drejtat e veta, si: e drejta e jetës, e drejta e familjes, e drejta e kujdesit shëndetësor, e drejta e arsimit, e drejta e votës, etj. Në qoftë se një qytetar nuk dëshiron të votojë, atëherë kjo do të jetë e dëmshme për vetë qytetarin dhe për shtetin tonë. Kjo pasi që vetëm e drejta e votës përcakton të ardhmen e një shteti.

Shumë vite më parë, zëri i gruas ishte i padëgjuar. Gratë nuk e kishin të drejtën e fjalës së lirë, apo të drejtën e vendimmarrjes dhe nuk trajtoheshin ashtu siç e meritojnë. Fundja, të gjithë jemi qenie njerëzore dhe meritojmë respekt dhe liri, pa asnjë lloj dallimi.

Në ditët e sotme, këto akte çnjerëzore janë zhdukur pothuajse në të gjitha shtetet demokratike. Ne mund të jemi gra apo burra, vajza apo djem, mirëpo për çdo qytetar, ligjet janë të njëjta.

Nëse në jetën e përditshme do të kishte diskriminim, nëse do të mungonte toleranca mes njëri-tjetrit, apo nëse do të mungonin ligjet, atëherë çdo qytetar do të ndihej i rrezikuar, i pambrojtur dhe i shtypur. Ai do të ndihej sikur peshku pa ujë, zogu pa krahë, apo foshnja pa nënë. Prandaj, janë ligjet. Këto rregulla na lehtësojnë jetën dhe na bëjnë të ndihemi të sigurtë.

Kur themi se çdo qytetar ka liri, nuk do të thotë që liria jonë mund të mposhtë të drejtat e tjetërkujt. Vetëm duke respektuar të tjerët, ne realizojmë qëllimet tona të përbashkëta. Po ashtu, në mënyrë që një shtet të ketë suksese e zhvillim pozitiv, paqja dhe toleranca duhet të mbizotërojë dhe demokracia duhet të jetë në nivel të lartë. Prandaj, atë që nuk dëshirojmë të na ndodhte neve, të mos mendojmë t'ia bëjmë dikujt tjetër. Lirinë që e kemi ne, le ta kenë të gjithë të tjerët. Kështu demokracia do të jetë në nivel të duhur.



Grupi „Gazetarët e së ardhmes“

NDIKIMI I MEDIAS NË DEMOKRACI

ADONIS (14), DONAT (14), ERON (15), RINA (14), ERNESA (14), KRENARE (14), ELZA (14)




Media njihet si „Pushteti i Katërt“. Mësojeni pse, përmes artikullit tonë

Teknologjia ka ndryshuar jetën tonë. Ky është një fakt. Ne duam t'iu tregojmë se si ju mund të ndryshoni jetën e dikujt, përmes teknologjisë dhe medias.

Në shkollën tonë mungonte autobusi i shkollës. E meqë ne kemi nxënës që vijnë në mësimin bashkë me ne dhe vijnë nga larg, kemi menduar se autobusi i shkollës sonë është i domosdoshëm. Prandaj, çfarë bëjmë ne? Duke përdorur rrjetet sociale, ne informuam

jante me një errësirë të vërtetë.

Kur arrin koha e zgjedhjeve, ne e votojmë një kandidat të caktuar. Më pas ai kandidat bëhet deputet. Mirëpo, ne nuk mund ta ndjekim atë deputet për të kuptuar veprimet e tij. Për këtë arsye, media na njofton për veprimet e përfaqësuesve tanë, të cilët punojnë në institucionin më demokratik të shtetit tonë, në Kuvend. Kështu, ne jemi të lirë të gjykojmë nëse përfaqësuesit e caktuar e meritojnë ose jo votën tonë, në të ardhmen.



nxënësit e shkollës sonë se duam të bëjmë një kërkesë në Komunë, në mënyrë që të na sigurohet transporti përmes një autobusi. Shembullin tonë e ndoqën edhe shkollat e tjera. Kështu, të gjithë nxënësit janë mobilizuar dhe aktivizuar për të përmirësuar jetën e tyre dhe të tjerëve.


Ky është ndikimi i medias në demokraci. Falë tyre, ne informohemi jo vetëm për vendin tonë, por për të gjithë botën. Paramendojeni sa e vështirë do të ishte sikur të mos kishim median. Jeta jonë do të përng-



Autorët e artikullit gjatë punës së tyre

ZGJEDHJE DEMOKRATIKE

ERMAL (14), SELVETE (14), ËNDRIM (14), BESIAN (14), RONA (14), ALBIN (14), ERONA (14),
BLINERA (14)



Nga e majta në të djathtë: Ilustruesi i redaksisë sonë, Albini, ka paraqitur një udhëheqës jo edhe aq të drejtë, i cili nuk i lejon qytetarët e vendit të tij të votojnë. Në ilustrimin tjetër, Rona me ilustrimin e saj ka paraqitur paqen

Ne votojmë, ata/ato na përfaqësojnë

Ne, shpeshherë kemi parë nëpër media sociale se si fëmijët lëndohen nga të tjerët dhe kemi parë se si bëhen padrejtësi ndaj racave të ndryshme. Ndoshta sepse në atë vend nuk ka të drejta e nuk ka barazi. Ndoshta me një fjalë nuk ka demokraci. Për të mos ndodhur këto që i përmendëm më lart, është shumë e rëndësishme që të respektohen të drejtat e njeriut. Respektimin e të drejtave të njeriut më së miri na e ofron një sistem i qeverisjes, që është demokracia.

Një ndër elementet kryesore në demokraci janë zgjedhjet e lira. Në jetën tonë të përditshme kemi plot zgjedhje. Ne zgjedhim se çka do të veshim, ose se cilën në mes të dy lojërave do ta luajmë.

Nga kjo kuptojmë se edhe pse jemi nën moshën 18

vjeçare ne mund të votojmë. Por, nuk mund të votojmë në procese zgjedhore të organizuara nga shteti, siç janë zgjedhjet lokale dhe ato qendrore.

Ne, qytetarët, të cilët jetojmë në demokraci kemi mundësi që vendin ta udhëheqim me anë të votës. Ka shumë rëndësi se kë vendosim ta votojmë. E më së miri është të zgjedhim kandidatin/en që më së shumti i prek interesat tona. Nëse një qytetar ka nevojë që në lagjen e tij të ketë infrastrukturë më të mirë, atëherë ky qytetar duhet të votojë kandidatin, i cili premton se do të rregullojë infrastrukturën në lagjen e tij.

Edhe pse ne tani nuk mund të votojmë në këtë lloj të proceseve zgjedhore, kur ne do të kemi të drejtë vote, do të votojmë gjithmonë për personat të cilët do të zhvillojnë lagjen, komunitetin ku bëjmë pjesë ne dhe të gjithë vendin tonë.



Kutia e votimit



Autorët e këtij artikulli në tavolinën e tyre të punës

ARSIMIMI, RRUGA DREJT SUKSESIT

VENERA (14), GJYLIZARE (14), ELDA (14), ARBNOR (14), ARLINDA (14), ALBERT (14), JON (14)

Demokraci nuk mund të cilësohet vetëm udhëheqja e institucioneve. Demokracia e shëndoshë varet shumë edhe nga shkalla e zhvillimit të qytetarëve, si dhe pjesëmarrja e tyre në të


Si çdo fëmijë i porsalindur i/e cili/a ka nevojë për nënën e tij/saj që të kujdeset për të, ashtu edhe shtetet kanë nevojë për një institucion që të mendoj për të mirën e tyre. Rolin e nënës, tek shtetet, e luan një institucion, rëndësia e të cilit është e patjetërsueshme. Ky është Kuvendi, funksionet e të cilit janë: funksioni përfaqësues, ai legjislativ dhe funksioni kontrollues. Kuvendi është institucioni më demokratik në vendin tonë. Kjo sepse personat, të cilët punojnë aty janë të zgjedhurit e popullit, të cilët ne i njohim si deputetë. Ani pse deputetët votohen nga qytetarë të ndryshëm, ata prapëseprapë punojnë për të mirën e të gjithë qytetarëve. Ata janë zëri i pothuajse 1.8 milion banorëve. Ne, qytetarët pa dyshim që i duam dhe i respektojmë ata, sepse falë tyre ne sot gëzojmë shumë të mira. Një ndër ato është arsimimi.

Ndoshta shumica e nxënësve që kanë shkruajtur artikuj dhe kanë diskutuar këtë temë më parë, si një të mirë që e gëzojnë nga Kuvendi, e kanë cekur arsimimin. Arsimimi është çelësi i suksesit dhe i një të ardhme të ndritur. Sipas Jonit, shokut tonë: „Librat dhe e drejta për t'i përdorur ato janë mrekullia që iu është dhënë të gjithë qytetarëve, pa asnjë dallim.“ Joni u shpreh kështu, sepse në mendje kishte shkrimtarin tonë të njohur botërisht, Ismail Kadare. Ky i fundit është sinonim i një arsimit dhe edukateje të mirëfilltë. Suksesi i tij nuk është vetëm personal, por është i të gjithë shqiptarëve. Në një mënyrë, Kadareja është ambasador




Kështu të dashur, të zgjuar dhe pozitiv do t'i sjellim vendit tonë shumë të mira, ashtu siç Kuvendi na sjell neve tash

dor i shqiptarëve në arenën ndërkombëtare. E si Kadareja, mundësinë për të arritur aty ku është ai, apo ndoshta edhe më lart, e kemi të gjithë ne. Për këtë i falenderohemi Kuvendit, që na jep mundësi të pafundme për t'u zhvilluar. Janë 120 deputetë, ata të cilët marrin vendime për të gjithë qytetarët dhe i përfaqësojnë interesat dhe nevojat e tyre. Pasi që, paska për detyrë të marrë vendime për të mirën e popullit, atëherë ky institucion duhet të sigurohet që të gjitha këto vendime apo ligje po zbatohen. Për këtë, Kuvendi kontrollon punën e Qeverisë, sepse ajo duhet të vë në funksion të gjitha ligjet e miratuara nga Kuvendi. Shtëpia më e madhe në vend është shtëpia e 1.8 milion banorëve.



Qytetarë të dashur, vota juaj bën ndryshim për të mirë. Një votë e juaj do të thotë një ligj më i mirë, një shkollë më shumë, apo edhe ekonomi më e zhvilluar. Votoni, jetësojeni të drejtën tuaj, zgjedhni vetë përfaqësuesit, sepse ju e meritoni të përfaqësoheni më së miri



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Hilmi Rakovica“
Klasa: IX-4
Vendi: Prishtinë